



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:121019
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05765894

C.nr.1204/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit B.D. nga Komuna P., të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “N...”, me seli në P. sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “D..”, me seli në P., me bazë juridike kompensim dëmi nga autopërgjegjësia, vlera e kontestit 9800 euro, jashtë seance, me datën 31.05.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit B.D. nga Komuna P., e parashtruar me datë 25.09.2020, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “D..”, me seli në P., me bazë juridike kompensim dëmi nga auto-përgjegjësia, vlera e kontestit 9800 euro.

II. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi B.D., përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “D..”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi nga auto-përgjegjësia, vlera e kontestit 9800 euro.

Gjykata, me datën 05.03.2024, në seancën përgatitore ka pranuar njoftimin nga paditësi, përkatësisht nga i autorizuari i tij, ku i njëjti ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurës me arsyetim se për këtë çështje kontestimore kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore. Gjykata njoftimin dhe procesverbalin mbi deklarinimin e të autorizuarit të paditësit mbi tërheqjen i ka dërguar edhe palës së padituri, e cila me datën 08.03.2024 ka pranuar, mirëpo të njëjtit nuk janë deklaruar.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më*

vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohej për këtë gjë, do të konsiderohej se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1204/20, me datë 31.05.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.